

## RAPORTI VJETOR I PUNËS – DREJTORIA E URBANIZMIT

Drejtoria e DPUPK është e ndarë në katër sektore, sektori i Urbanizimit, Pronës dhe Çështjeve pronësore juridike, Kadastrit dhe Gjeodezisë, ku secili nga këta sektorë është i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme. Të gjithë sektorët punët i kanë përfunduar me përkushtim të plotë duke i respektuar normativat ligjore në fuqi dhe afatet ligjore, duke u ndarë të knaqur edhe me qytetarët edhe me vetë eprorët që është dashur të raportojnë për punët e përfunduara. Kështu puna e kryer gjatë viti 2019 ka qenë një punë produktive dhe këto punë po i paraqesim më poshtë për çdo sektorë veq e veq:

### SEKTORI I PRONËS

Gjatë vitit 2019 **Sektori i pronës** dhe çështjeve pronësore juridike në kuadër të DPUPK-së ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me planprogram si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor, ku të gjitha këto aktivitete janë përmbyllur me sukses brenda afateve ligjore gjatë tërë viti. Përveç punëve të cilat janë kryer si përshebull në bartjen e pronës në regjistrimin dhe fshirjen e hipotekës dhe regjistrimin e ngarkesave të tjera ligjore si barrë tatimore etj, sektori jonë ka kryer edhe punë më specifike si në vijim :

- Me qëllim të realizimit të projekteve të ndryshme , gjatë muajit shkurt me iniciativën e Kryetarit të Komunës kemi përgaditur Propozim Vendimin Nr.II-131 e dt.15.2.2019 për shpalljen me interes të përgjithshëm për parcelat kadastrale të cilat evidentohen në emër të KEK sh.a . në zonën Kadastrale në Obiliq dhe për të njëjtat i jemi drejtuar organeve kompetente respektivisht Qeverisë së Republikës së Kosovës që parcelat në fjalë që të barten në emër të Kuvendit Komunal Obiliq (Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës me nr.06/115 dt.17.12.2019) .

Duke u bazuar në Vendimin e Kuvendit Komunal Nr.I-108 dt.31.07.2018 dhe në legjisllacionin në fuqi dhe me qëllim të realizimit të projektit Ndërtimi i Sheshit të Qytetit, kemi filluar procesin e Shpronësimit për Njësitë Kadastrale të cilat atakohen nga projekti i lartëcekur , procesi i shpronësimit për këto njësi kadastrale nuk ka përfunduar ende për arsye se pronarët dhe zotruarit e interesit kanë paraqitur ankesë në Gjykatën kompetente dhe jemi në pritje të Vendimit nga Organet e Drejtësisë .

Po ashtu në kuadër të Objektit ku është duke u shpronësuar ndodhen edhe tri lokale për të cilat pasi që nuk janë të regjistruara në operatin kadastral i jemi drejtuar organeve të ndryshme me qëllim të evidentimit dhe të marrjes së informacioneve se kush menaxhon me to. Vlenë të ceket se prej këtyre tri lokaleve vetëm njëri është arritur të identifikohet dhe i njëjti sipas informacioneve nga AKP-ja gjendet nën menaxhimin e AKP-së .

Me kërkesën nr. XVII-298 e dt.26.09.2019 nga ana e Drejtorisë së Infrastruktues lokale po ashtu me iniciativën e Kryetarit të Komunës kemi përgaditur Propozim Vendimin Nr.II-1057 dt.18.10.2019 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale Nr.00784/2 në zonën kadastrale në Plemetin, parcela në fjalë do të shpronësohet për arsye se sipas kërkesës së Kërkesës së Drejtorisë së Infrastrukturës Lokale e njejta do të atakohet me rastin e realizimit të projektit kapital dhe shumë të rëndësishëm ndërtimi i rrugës “Hoxhë Ali Qerkezi “ në Milloshevë e cila lidhë fshatrat e Qyqavicës përmes Plemetit me fshatin Milloshevë .

Gjatë muajit Korrik me iniciativën e Kryetarit të Komunës kemi përgaditur për Kuvendin Komunal Propozim Vendimin Nr. II-795 të dt.25.07.2019 për Shpallje me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale në zonën kadastrale në Caravodicë të cilat evidentohen në emër të KEK Sh.a . dhe për të njejtat në të ardhmen e afërt do të kërkohet nga Qeveria e Republikës së Kosovës të barten në pronësi të Komunës pasi që Komunës i nevojiten për realizimin e projekteve të ndryshme në këto parcela .

Pjesmarrja në takime tjera nuk ka munguar gjithmonë në ato që janë të favorshme dhe të domosdoshme për punën efektive të sektorit tonë, si: Punëtorja së bashku me komunat tjera në prezentimin e udhëzimit administrative për hartimin dhe miratimin e projekt Ligjeve të ndryshme ,pastaj pjesmarrja në trajnime të ndryshme lidhur me duhizimet e reja Administrative të nxerrura nga Agjensioni Kadastral i Kosovës.

Spektori jonë sa i përket punëve brenda Komunës, cekim se kemi kryer me përgjegjësitë plotë punët si anëtarë të komisioneve si në vijim :

Në kuadër të Komisionit për verifikimin e gjendjes në teren për kushte ndërtimore së bashku me dy anëtarët e tjerë të Komisionit kemi kryer punën me përgjegjësi të plotë ku kemi arritur gjithsej 78 raste.

Kjo ka qenë një përmbledhje e shkurtër e punëve të këtij sektori gjatë vitit 2019.

**Gjat Vitit 2019 kemi pas gjithësejt 1126 - kërkesa për lëndë të ndryshme dhe ate:**

<b>1.Kontrata te shtitblerjes</b>	<b>336</b>	
<b>2.Kontrata per ndarjen e paluajtshmerisë</b>	<b>75</b>	
<b>3. Aktvendime të Trashegimisë</b>	<b>70</b>	
<b>4.Rexhstrim i Hipotekes</b>	<b>43</b>	
<b>5.Fshirje e Hipotekes</b>	<b>46</b>	
<b>6.Kontrata te faljes (Dhurimi)</b>	<b>89</b>	
<b>7.Parcelizim (Ndarje)</b>	<b>143</b>	
<b>8.Bashkim dhe Ndarje</b>	<b>24</b>	
<b>9.Kthim i Kufijve</b>	<b>10</b>	
<b>10.Rexhstrim i Objektit</b>	<b>00</b>	
<b>11. Rexhister i Kordinatave</b>	<b>131</b>	
<b>12.Rexhstrim i Parcelave</b>	<b>00</b>	

13.Modifikim për Personin	26	
14.Vendim Gjyqësor	03	
15. Kontrata te Qiramarrjes se Objektivit te Banimit	00	
16.Kontrata te kembimit ( ndrrimi )	12	
17.Parcelizim dhe Rregullim i Kufirit	00	
18.Vendim Perfundimtar	03	
20 Historiati i prones	11	
21.Vendim Shpronësimi	17	
22.Vendim i Qeverise	4	
23. Barra Tatimore	2	
24. Bashkim i Paecelave	15	
25. Qiramarrje per 99 vite	15	
26.Vendim per mbajtje te Perhershme	06	
27. Kërkesa	32	
28.Azhurim i gjendjes ne Grafik	03	
29.Bashkim dhe Rexhistrim i Parcelave	00	
30. Ndryshim i Hipotekes	01	
31.Rexhistrim i ndërteses	00	
32. Lirim Nga barra Tatimore	01	
33. Urdher nga Permbartuesi		00
34. Lirim nga barra Tatimore		01
35. Bashkim i Parceles dhe Rexhistrim i Ndërteses		01
36. Anulim i Mases se Prrkohshme		03
37.Vertetim		01
38. Ankese		01
39. Njoftim nga AKP-ja		01

*Te Hyrat Vjetore Janar-Dhjetor 2019 ne Gjeodezi Pronë dhe Kadaster janë: 78,583.5 euro*

*Te Hyrat ne Urbanizem Janë:84,672.28*

*Te Hyrat totale janë : 163,255.8 euro*

## SEKTORI I GJEODEZISË DHE KADASTRIT

Gjatë vitit 2019 **Sektori për kadastër** ka arritur që të realizoj në aspektin e të hyrave vetanake njëkohësisht dhe e kemi tejkaluar.

Ne si Sektor i Kadastrit jami kujdesur per respektimin e ligjeve dhe kemi mbajtur përgjegjisi ne ligjet e Kadstrit dhe udhëzimet administrative te nxjerra nga AKK.

Zhvillimin e procedurave te regjistrimit te kërkesave , sipas detyres zyrtare dhe kerkeses se paleve;

Korrigjimin e regjistrit (SIKTK-së) sipas procedurave dhe zbatimin e të gjitha dispozitave ligjore në fuqi;

Regjistrimin e pronave të palujtshme dhe regjistrimin e pronave komunale;

Azhurimin e pronave në bazë të dokumentacionit të leshuara nga Gjykatat, Noterët, si dhe organet përgjegjëse Vendimet e Kuvendit, Vendimet nga AKK si dhe vendime tjera etj;

Zbatimin e procedurave rreth bartjeve të pronave duke u bazuar në Kontrata të Shitblerjes, Kontrata të

Dhurimit, Kontrata për Ndarjen e Paluajtshmeris, Aktvendimet e Trashigimis si dhe rëxhistrimin në sistemin e SIKTK-së

Shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative për evidentimin dhe shlyrjen e masave të perkohshme sipas aktvendimit të gjykatës kompetente;

Udhëheqjen me kadastrë etazhë të banesave, ndërtesave, pjesëve të ndërtesave si dhe ngastrat kadastrale në të cilat janë ndertuar banesat;

Regjistrimin dhe çregjistrimin e hiptekave; aktvendimeve mbi regjistrimin e servituteve, rëxhistrimin e barrave tatimor dhe rëxhistrimin e qirambajtjeve;

Leshimin e certifikatave personave që nuk kanë patundshmeri, çertifikatave mbi të drejtat e pronës së paluajtshme si dhe kopje planit;

Nxerrjen e aktvendimeve për miratim e ndarjeve të parcelave, bashkimin e parcelave apo refuzim të kërkesave;

Nxerrjen e konkluzioneve për plotsimin e kërkesave të pakompletuara;

Përgaditjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin punës;

Punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore (shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe institucioneve tjera).

Zhvillimin dhe organizimin e sistemeve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale, modelin e sistemit informatik për tokën dhe pronën;

Rëxhistrimin e ndarjeve të parcelave dhe modifikimin etributeve të parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.

Kryerjen e punëve profesionale, të cilat dalin nga gjeodezja (ndryshimet e bërë gjatë matjeve nga Hartat e Kosovës dhe bartjen e tyre në programin e SIKTK-së.

Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara (dhenien e kordinatave për terren);

Si dhe Shërbime profesionale dhe shërbime të tjera ,për subjekte dhe institucione të ndryshme;

Si dhe për fund kemi marr pjesë në trajnime, seminare të ndryshme për zhvillimin e njohurive që të jemi sa më transparent në kryerjen e shërbimeve ndaj Qytetarëve të Komunes.

Në përfundim të këtij raporti për vitin 2019 konstatohet se kemi arritur të përfundojmë varësisht prej natyrës së lendeve, Kontrata, Vendime, Kërkesa të ndryshme, Çertifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Kopje Plani si Çertifikata që nuk posedojmë Pronë gjithsej 6806 kërkesa.

## **SEKTORI I GJEODEZISË**

Ky raport përmban një përmbledhje në vijë të trasha të punëve gjatë vitit 2019. Në raport do të përfshihen punët e përfunduara nga sektori në aspektin profesional sipas kërkesave të parashtruara nga ana e drejtorive të KK Obiliq të cilat lidhen drejtperdrejt me punë profesionale në terren e që janë situacione të ndryshme për nevojat e projektimit, matje të parcelave – kufiëve për ndërtimin dhe planifikimin e rrugëve, elaboratet e shpronësimit dhe identifikime të ndryshme me matje.

Në cilësinë e Anetarit të Komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore është punuar shumë në vitin 2019 pasi që natyra e punës kërkon dalje në terren në vendngjarje dhe në rastet kur punët kanë filluar realizojmë matje gjeodezike për të përcaktuar pozicionin e sakt të objektit.

Pasqyra e lendeve të përfunduara në kuadër të mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit do të paraqitet me një tabelë të veçantë dhe do të bashkohet këtij raporti ndërsa ky raport me shkrim do të përfshijë vetëm punët dhe shërbimet që janë kryer sipas kërkesave të Drejtorive brenda Komunes.

Në cilësinë e anetarit të komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore është punuar në gjithësej 78 lende gjatë vitit të kaluar, në shumicën prej lendeve janë bërë matjet për përcaktimin e pozicionit të objekteve dhe janë punuar skicat së bashku me raportin e komisionit.

Ky raport përmban kryesisht punët nga lëmia e punëve inxhinjerie gjeodezike për projekte të ndryshme komunale ndërsa punët në lëmin e mirëmbajtjes së rregullt të kadastrit do të paraqesim në formë tabelare për çdo zonë kadastrale si dhe totali i lendeve të përfunduara në vitin 2019.

Ne Krushevc eshte punuar ne matjet e kanalizimit te hekurudha ne gjatesi mbi 600 m kanalizimi te lagja e Raqeve si dhe jane bere matjet te hiri (Kosova "A") ne lidhje me projektin e pyllzimit.

Ne Llazareve jane bere matje ne teren per percaktimin e pozites se kanalit IBER LEPENC pjesa e cila kalon me gypa nentoksor gjithashtu ne Llazareve jane bere matjet e terenit per hartimin e situacionit per projektin e parkut te fshatit Llazareve

Ne Mazgit jane matje per projektin e kanalizimit atmosferik nga Auto udha I cili kalon neper fshat dhe shkarkohet ne kanal in e kullimit, gjatesia mbi 800 m. Gjithashtu jane bere matjet e kanalizimit te Xhamia ne lagjen e Raqeve.

Matejt gjeodezike situacioni I terenit prona komunale Mazgit i Ulet per nevoja te drejtorise se Aresimit. Gjithashtu jane bere matje plotesuse ne pronen komunale per situacionin e terenit Mazgit i Ulet.

Ne Millosheve matje te situacionit te terreni te shtepia e kultures.

Ne Obiliq matje te kanalizimit te QKMF, gjithashtu matje te kanalizimit ne lagjen Shkabaj. Situacioni I trenit ne Obiliq afer KEK-ut per rregullimin e hapsres publike si dhe situacioni I terenit te hekurudha per projektin e Unazes se qytetit Obiliq.

Ne Plemetin jane bere matje per projektin e kanalizimit prej lumit Sitnica deri ne lidhje mbi hekurudhe gjatesi 2538 m. Gjithashtu ne Plemetin matjet e kanalizimit te lagja e romeve ne gjatesi mbi 500m.

Ne Raskove jane bere matjet gjeodezike te situacionit te terenit fusha sportive per nevoja te rregullimit te hapsirave publike.

Ne Hamidi matje te gjendjes faktike te rruges se asfaltuar qe lidhe fshatin Hamidi me fshatin Sibovc per te konstatuar nese gjate ndertimit te rruges ka pase nderhyrje apo demtim te pronave private.

Te gjitha punet e pershkruara me larte kerkojne pune pregaditore ne zyre dhe pune ne perpunimin e te dhenave ne formen digjitale te cilat marrin kohe te konsiderushme ne finalizim e situacioneve dhe elaborative varesisht prej natyres se punes.

Gjate viti 2019 ka pase mjaft kerkesa zyrtare nga palet per matje kadastrale kryesisht ne percaktimin e kufijeve te rrugeve gjate ndertimit.

Pune ne cilesin e anetarit te komisionit per pranimin teknik te projekteve komunale.

Ne cilesin e aneterit te komisionit per caktimin e kushteve ndertimore gjate vitit 2019 ka pase gjithesejt 78 lende te cilat jane shqyretuar brenda afatit te parapare me ligj.

### RAPORTI VJETOR

<b>Pasqyra vjetore e lendeve nga Rexhistri i Fleteparaqitjes 2019</b>					
<b>Zona Kadastrale</b>	<b>Ndarje</b>	<b>Bashkim</b>	<b>Shprosim</b>	<b>Korrigjim Kufirit</b>	<b>Total</b>
Babimoc	4	1	4	1	<b>10</b>
Bakshi	2	2	0	0	<b>4</b>
Breznica	4	2	0	0	<b>6</b>
Caravodica	4	1	0	0	<b>5</b>
Graboc i Eperm	1	0	0	0	<b>1</b>
Hade	3	0	0	0	<b>3</b>
Hamidi	3	1	0	0	<b>4</b>
Kryeshevc	6	0	0	0	<b>6</b>
Leshkofshiq	2	0	0	0	<b>2</b>
Llazarevë	3	2	6	0	<b>11</b>
Milloshëve	18	2	1	1	<b>22</b>
Mazgit	16	2	3	0	<b>21</b>
Obiliq	41	15	0	2	<b>58</b>
Plemetin	19	3	0	0	<b>22</b>
Raskovë	7	2	0	0	<b>9</b>
Sibovc	30	10	0	0	<b>40</b>
Shipitullë	7	1	0	1	<b>9</b>

<b>Total</b>	<b>170</b>	<b>44</b>	<b>14</b>	<b>5</b>	<b>233</b>
--------------	------------	-----------	-----------	----------	------------

## SEKTORI I URBANIZMIT

-Gjatë vitit 2019 sektori i **urbanizmit** në kuadër të DPUPK ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me planprogram si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme, e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor, ku të gjitha këto fushëveprime janë përmbyllur me sukses brenda afateve ligjore gjatë tërë vitit.

-Kemi filluar së bashku me komunat tjera në takime të ndryshme të organizuara nga MMPH në bashkëpunim me OSBE-në dhe USAID-in, mënyrën se si do të fillojmë me aplikimin e Ligjit të ndërtimeve pa leje me 06/L-024, e poashtu edhe harmonizimin e udhëzimeve administrative në mënyrë që të jenë sa më të aplikueshme nga qytetarët e që pritet mbrenda këtij viti të aprovohen dhe të fillojmë me paisjën e qytetarëve me vendime për legalizim të objekteve.

-Plotësimi I formularëve të performancës për vitin 2019, e cila përsëritet qdo fundvit, kërkesë e MAPL.

-Takim me personat përgjegjës të sektorit për PPP nga Ministria e Financave që merren me sqarimin e procedurave për projektet që kërkohet të procedohen përmes marrëveshjeve për Partneritet Publiko Privat.

-Disa komente lidhur me nevojat dhe kërkesat në **Projekt Udhëzimin Administrativ MMPH për Kërkesat Themelore për Shëndet dhe Siguri, Procedurat dhe Dokumentacionin për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje Të Kategorisë I dhe II.**

-Punimi i Organigramit për drejtorinë tonë DPUPK.

-Pjesmarrja në trajnimin e organizuar nga Asociacioni I Komunave, lidhur me Udhëzimin administrativ për procedurat e legalizimit të objekteve.

-Takimet e rregullta të përbashkëta së bashku ekipa e grupit të performancës me kryetarin e Komunës.

-Pregaditja e dokumentacionit për tender për konsulent për Planin Zhvillimor Komunal.

-Vendosja e të dhënave për drejtorinë tonë në Eëb faqen e Komunës së bashku me IT-in e Komunës.

-Pjesmarrja në takimin e mbajtur në hotel "Venus", për të gjithë inxhinierët ku është bërë prezentimi I programit "Autodesk".

-Takim me përfaqësuesin e USAID-it tema Planin Zhvillimor dhe mundësia e USAID-it për të ndihmuar në fushatën për informimin e qytetarëve lidhur me rëndësin e pjesmarrjes së tyre në procedura.

-Një njoftim për Sektorin e Hetimeve të Korrupsionit, lidhur me disa objekte të ndërtuara në teritorin e Komunës tonë.

-Puna e menaxhimit në projektin "Hartimi I Planit Zhvillimor Komunal" si dhe nënshkrimi i kontratës ndërmjet punëkryesit dhe Komunës.

-Takim me Kompanin "INSI" për prezentimin e procedurave të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

-Takim I grupit punues të Komunës me kompanin "INSI" lidhur me fillimin e procedurave për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe ndarja e detyrave për grupin punues.



- Pregaditja e dokumentacionit për prokurim për shpalljen e konkursit për Hartimin e Hartës Zonale të Komunës.
- Takim me grupet e interes që do të jenë direk të kyqura gjatë hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.
- Pjesmarrja në trajnimin e organizuar nga OSCE-ja për procedurat e dhënjes së tokave në shfrytëzim.
- Puna e vazhdueshme në Hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës, takimet me kompanit e ndryshme, takimet me komision, me grupet e interes, një punë intensive me përgjegjësi maksimale.
- Puna në ndryshimin e Statutit të Komunës, i cili është përgaditur të dal në KK Obiliq për aprovim.
- Kemi paisur palët me dokumente në mënyrë që t'iu mundësohet aplikimi në Ministrinë e Bujqësisë për përfitim të granteve qeveritare e poashtu edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me kërkesat e tyre për ndërtimin e shtëpive për të rikthyerit dhe për minoritete, ju kemi kthyer përgjigjeje në kërkesat e tyre për zonat se ku lejohet ndërtimi e ku jo.
- Takim në hapsirat e Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, lidhur me hapjen e fushatës së legalizimit të objekteve.
- Pjesmarrja në Trajnimin të organizuar nga MAPH në bashkëpunim me USAID-in, lidhur me procedurat e trajtimit të ndërtimeve pa leje.
- Takim me përfaqësuesit e KOSST, KEDS,KEK,IBER- LEPENC,COUNTOUR GLOBAL,KUR –PRISHTINA, “INSI”, lidhur me procedurat e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.
- Mbajtja e Debatit Publik të pare me qytetarë për Planin Zhvillimor të Komunës, për profilin e gjendjes aktuale të komunes –nentor 2019.
- Raport për ATK-në lidhur me lejet ndërtimore nga viti 2013-2019.
- Takim me auditorin e brendshëm, lidhur me procedurat e paisjes me leje ndërtimore-ashtu siq është paraparë me plan të veprimit për vitin 2019
- Raport lidhur me të gjeturat e auditorin e brendshëm për procedurat e paisjes me leje ndërtimore.
- Jemi ndarë të knaqur çdo herë me Inspektoratin e MMPH, lidhur me kontrollat e kohpaskohëshme që I bëjnë sektorit tonë për rrjedhën e punëve lidhur me paisjen e palëve me leje ndërtimore dhe zbatimin e proceduarve ligjore në përpikmëri.
- Pjesmarrja në takimin e organizuar nga Asociacioni I Komunave lidhur me procedurat e legalizimit.
- Mbajtja e debatit të dytë public me qytetarë në muajin dhjetor, për Vlerësimin e gjendjes së komunës së Obiliqit.
- Si dhe shumë punë të tjera që janë të lidhura me sektorin e urbanizmit, duke cekur edhe konsultimet me palë lidhur me punët që I takojnë natyrës së punës tonë.
- Kjo ka qenë një përmbledhje e shkurtër e punëve të sektorit të urbanizmit gjatë vitit 2019.
- Më poshtë do të cekim lëndët që janë të lidhura me të hyrat në sektorin tonë.

- 69 vendime për kushte ndërtimore,
- 53 vendime për leje ndërtimore,
- 2 leje përdorimi,
- 4 leje rrënimi,
- 46 vendime për refuzim,

- 14 përgjigjeje palëve,
- Si dhe njoftimet për qytetarë në kërkesat e ndryshme.

## RAPORTI VJETOR I PUNËS – DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Drejtorja për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke u mbështetur në kompetencat të cilat derivojnë nga ligji për vetëqeverisje lokale, e ngarkuar me punët nga statuti i Komunës ka realizuar detyrat e hartuara për vitin 2019.

Duke i dhënë prioritet zhvillimit të bujqësisë, mbështetja ka filluar me përkrahjen e ekonomive të vogla familjare bujqësore, dhe rritjen e interesimit të qytetarëve për qasje më konstruktive në këtë lëmi. Për të gjitha projektet jemi konsultuar dhe kemi marr propozimet nga fermerët e sektorëve të veçantë.

### AKTIVITETET E PUNËS

Bujqësia është një sektor i rëndësishëm potencial për zhvillimin ekonomik, për këtë arsye kemi vazhduar me projektet si:

1. “Ngritja e serave tunel 50 m<sup>2</sup> për parim-kulturë”.
2. ” Moto kultivator me retrofrezë”.
3. “ Makina mjelëse për blegtorë ”.
4. “Pajisje për Bujqësi”.
5. “ Vaksinimi dhe inseminimi artificial i gjedheve”.
6. “Subvencionimi me mjedra”.
7. “Subvencionimi për Qumësht “.
8. “Subvencionimi për Bletar të rinjë”.
9. “Subvencionimi me dhi qumështore”.
10. “Subvencionimi me Farë gruri dhe naftë.

Drejtorja në këtë periudhë ka bërë vazhdimisht monitorimin e pyjeve të komunës.

Drejtorja ka organizuar 10 trajnime me këshilla nga stafi i qartefikuar me fermerët në koordinim me MBZHR.

Kërkesa për prerje të pyjeve private ka qenë një, e cila është bartur në Agjencionin e Pyjeve të Kosovës .Me agjencionin e pyjeve ka qenë në koordinim dhe inspektim gjatë Nëntor dhe dhjetor ku kanë konfiskuar një numër të konsiderueshëm të druve .

Në tabelë është paraqitur ndarja e subvencioneve për gjashtë mujorin e parë vitin 2019

Emërimi i projekteve për subvencionim	Shuma e subvencioneve
Projekti - “Ngritja e serave tunel 50 m <sup>2</sup> për perimë-kulturë”.	29.298,50€
Projekti- ” Moto kultivator me retrofrezë”.	21.500.00€
Projekti- “ Makina mjelëse për blegtorë ”.	10.000.00€
Projekt - “ Pajisje Bujqësore ”	20.400.00 €
Projekti- “ Vaksinimi dhe Inseminimi i gjedheve ”	32.300.00€
Projekti- “ Dhi qumështore ”.	6.400.00€
Projekti- “Subvencionimi me Mjedër Meker”	10.123.00€
Projekti- “Subvencionimi Qumështit”	24.833.12€
Projekti – “Subvencionimi me Bletë”	13.800.00€
Projekti –“Subvencionimi me Farë gruri dhe naftë	18.669.36€
Projekti - “Ngritja e serave “ 2018	2,078.00€
Bashkëfinancim për Sera 2018	5,674.00€
Totali	195,075.48€

1. Projekti Ngritja e serave tunel ka përfunduar me 04.05.2019. dhe kanë përfituar: 70 fermer
2. Projekti moto kultivatorëve ka përfunduar me 21.05.2019 dhe kanë përfituar: 50 fermer
3. Projekti Makina mjelëse ka përfunduar 21.05.2019 dhe kanë përfituar: 40 fermer
4. Projekti Pajisje bujqësore ka përfunduar me 21.05.2019 dhe kanë përfituar: 38 fermer
5. Vaksinimi ka përfunduar 22.04.2019 dhe janë Vaksinuar 4015 Kafshë, si dhe janë insiminuar mbarsura artificialisht 1500 gjedhe për një vitë.
6. Projekti subvencionim me mjedër ka përfunduar 02.05.2019 dhe kanë përfituar: 4 fermer
7. Projekti subvencionimi i qumështit për tre mujori e parë ka përfunduar 27.06.2019 dhe kanë përfituar: 23 fermer.
8. Projekti subvencionimi me Dhi qumështore ka përfunduar me 29.07.2019 kanë përfituar: 32 fermer.
9. Projekti subvencionimi me bletë ka përfunduar me . 29.07.2019 kanë përfituar: 46 fermer.

10. Projekti subvencionim me Farë gruri dhe naftë 01.10.2019 kanë përfituar: 163 fermer.
11. Kemi pas një donacion nga organizata ASB për bujqësi nëpërmes Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale ku kanë përfituar: 18 Familje.
12. Kemi pas një donacion me bashkë financim nga Helpi ku kanë përfituar: 8 fermer.
13. Projekte nga OJQ IADK ku kanë përfituar: 6 fermer

## RAPORTI VJETOR I PUNËS – DREJTORIA E KULTURËS, RINIS DHE SPORTIT

Drejtorja e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, duke u bazuar në objektivat dhe synimet e drejtorisë dhe duke u bazuar në fushëveprimtaritë që zhvillon, për periudhën janar-dhjetor, në sektorin e kulturës gjithashtu edhe në sektorin e rinisë dhe sportit, ka realizuar këto; Aktivitete:

- Shënimi i Manifestimit Kulturor me rastin e përvjetorit të 11-të shtetësisë së Kosovës, nën moton *“Kosova Nder dhe Detyrë”*
- Organizimin e Krosit Pranveror në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve Shkollorë
- Shënimi i Manifestimit Përkujtimor 5-Maji/ Dita e Dëshmorëve
- Dita e Komitetit Olimpik , ku DKRS-ja në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës ka mbajtur manifestim (Vrapim) për ditën olimpikë të Kosovës me nxënës të moshës 11 vjeçare që njihen si *“Pëllumbat e Pavarsisë”*
- 1 Qershori dita ndërkombëtare e fëmijëve, Drejtorja e kulturës, rinisë dhe sportit në bashkëpunim me OJQ –ën *“ Ballkan Sunfloëers”* kanë organizuar në sheshin *“Aziz Zhilivoda”* aktivitete të ndryshme për fëmijë.
- Shënimi i Manifestimit Kulturor **“Qershori, Muaji i Krenarisë sonë”** në kuadër të së cilit është përvetësuar edhe Shtëpia e Kulturës *“Xhavit Haziri”* në praninë e shumë mysafirëve nga niveli qendror dhe lokal dhe qytetarëve të Komunës së Obiliqit.

Aktivitete Sportive për nder të muajit të krenarisë;

1. Turnir ndërmjet shkollave të futbollit
2. Turnir në volejboll ekip vajzash
3. Turnir boks në palestrën Sportive *“Adem Jashari”*
4. Fluturim i praglajding

#### 5. Paradë- Kalim me kuaj në qytet

- Mbahen garat për perzgjedhjen e talentëve të rinjë në këndim “Une kam talent”
- Stafi i DKRS –se ishin të pranishëm në takimin me MKRS -në të cilët bënëshpërndajën e 130 libra të ndryshëm për disa komuna në mesin e tyre ishim dhe ne Komuna e Obiliqit.
- Shënimi i Manifestimit kulturorë për mërgatën “ Ditët e Diasporës”
- Garat komunale në Futsall të organizuar nga DKRS në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Edukatës Fizike , ekipet fituse nga komuna jonë kanë marrë pjesë në Gara Regjionale ku shfmu “ Pandeli Sotiri” zënë vendin e parë dhe vendin e tretë në Gara Republikane. Ndërsa dy ekipet e shkollës së mesme profesionale “Ismail Dumoshi” fitojnë vendin e dytë në Gara Regjionale.
- DKRS në bashkëpunim me Federatën e Hendbollit të Kosovës organizoj licencimin e trajnerave të Kosovës. Trajnimin e mbajnë Dr.prof Lidia Bjelliq e vetmja ligjeruese e Federatës Botërore në Hendboll. Trajnimi dy ditorë u mbajtë në palestrën sportive “Adem Jashari”
- Garat komunale në Basket të Organizuara nga DKRS në bashkëpunim me Shoqatën e Pedagogëve të Edukatës Fizike.
- Garat Regjionale për shkollat fillore dhe të mesme organizohen më DKRS- ën dhe Federatën e Sportit Shkollorë. Ekipa e shkollës fillore e zë vendin e tretë.
- DKRS në bashkëpunim me Komitetin Olimpik të Kosovës organizojn “ Panairin e Sportit” pjesëmarrës ishin 20 klube të Komunës së Obiliqit dhe të pranishim ishin sekretari i përgjithshëm i KOK , Z. Shasivar Haxhijaj dhe nënkryetari Ibush Mjekiqi.
- DKRS merr pjesë në Konferencën e tretë e cila u mbajtë në kuadër të KOK- ut me temën “Barazia Gjinore dhe Diverziteti”
- Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sportishin të pranishëm me Qendrën Rinore të Komunës së Obiliqit në Kongresin Kombëtar për të rinjë të Kosovës mbështetur nga OJQ -ja “Friendrich – Ebert – Stiftung” Temat : Vetëdijesimi për rëndësin e votës; Prioritetet në programet e tyre politike të subjekteve politike; Fuqizimi i të rinjëve të bëhen aktive në jetën shoqërore dhe politike.
- Stafi i DKRS-së ishte pjesëmarrës në “ Kastrioti Open” organizuar OJQ- në “ Shqiponjat e Kastriotit” e cila u mbajtë në majen e malit Golesh.

- Stafi i DKRS- së ishte pjesëmarrës në manifestimin letrar “Dritat Poetike “ e organizuar nga Shoqata “ Fahri Fazliu”
- Ndonëse, ishte planifikuar kremtimi i 28 Nëntorit-Dita e Flamurit Kombëtar, për shkak të rrethanave që u krijuan në Republikën e Shqipërisë, si pasojë e tremeteve, ky manifestim kulturor u pezullua.  
Dokumentet e Hartuara nga DKRS-ja
- Është hartuar Draft-Strategjiapër Zhvillim të Turizmit dhe Promovimtë Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Obiliqit.
- Grupi punues i DKRS-së, ka hartuar rregulloren për menaxhimin e Shtëpive të Kulturës në Komunën e Obiliqit, rregullore kjo e cila është miratuar edhe nga Kuvendi Komunal.
- Grupi punues i DKRS -së ka hartuar edhe rregullorën për shfrytëzimin e palestrës sportive “Adem Jashari” objekteve sportive dhe fushat të hapura publike në Komunën e Obiliqit, rregullore kjo e cila është miratuar edhe nga Kuvendi Komunal.
- Poashtu me kërkesën e Ansambllit tëQytetit për themelin e saj në kuadër të komunës, është miratuar nga Kuvendi Komunal në mënyrë unanime.
- Me vendimin e kryetarit të Komunës, është emëruar komisioni për verifikimin, saktësimin e të dhënave biografike, gjeografike dhe kronologjike për të rënë në periudhën e luftës në Komunën e Obiliqit.Duke ju referuar listave egzistuese mbrenda institucionit komunal, kontakteve me institucioneve qendrore, kontaktet me shoqata, familjarë dhe personave tjerë njohës të këtyre çështjeve, është finalizuar lista e saktë e të gjithë martirëve të rënë në Komunën e Obiliqit.
- Janë dërguar të dhënat e kërkuar nga segmente të ndryshme në fushëveprimtaritë e DKRS-së, për hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës së Obiliqit.
- Gjatë realizimit të aktiviteteve sportive kemi pasur gjithësej 1300 fëmijë pjesmarrës.

#### **Bashkëpunimet me institucionet tjera relevante**

- Është bashkëpunuar ngushtë me drejtorinë e urbanizmit(janë realizuar vizita në terren) dhe drejtoritë e tjera lidhur me projektet kapitale nga fusha e trashëgimisë kulturore dhe projekteve tjera në segmente të caktuara.
- Janë dërguar të dhënat statistikore nga fusha e kulturës të kërkuara nga Agjencia e Statistikave të Kosovës.

- Janë dërguar të dhënat e kërkuara nga Agjencia për Menaxhimin e Komplekseve Memorial lidhur me monumentet historike që kanë shtrirje në Komunën e Obiliqit.
- Janë realizuar takime konsultative me Këshillin për Trashëgimi Kulturore lidhur me draft-Strategjinë për Zhvillim të Turizmit dhe Promovim të Trashëgimisë Kulturore në Komunën e Obiliqit.
- Janë realizuar takime me Institutin e Arkeologjik të Kosovës në lidhje me Memorandumin e Bashkëpunimit për të filluar Gërmimet Arkeologjike në Komunën e Obiliqit
- Takimi në MKRS me drejtorin në departamentin e rinis, z. Feim Hoxha, në lidhje me ndërtimin e Qendrës Rinore në komunën tonë.
- Kemi zhvilluar takime të shpeshta me përfaqësues të OJQ- ve kulturore dhe sportive për tu njohur me procedurë e aplikimit e thirrjeve publike, njëkohësisht janë realizuar edhe takimet për t'u dhënë mundësi lidhur me kërkesat e tyre teknike po edhe kërkesat të natyrës tjetër për inventarizimin e objektit të shtëpisë së kulturës “ Xhavit Haziri”
- Janë realizuar disa takime me Komitetin Olimpik të Kosovës për realizimin e organizimeve në bashkëpunim me KOK.
- Takim me përfaqësuesin e USAID- it, z. Armend Aliu dhe Naser Ashimi , në lidhje me projektin Lega
- Takimi me kordinatorët e OJQ-së Play Internacional nga Ambasada e Francës Claire Chapelier – Menager dhe Senad Ramani – Project coordinator
- Kemi realizuar takim me z. Rexhep Hoti - Kordinatori Nacional për Kulturë , Rini dhe Sport për të biseduar në lidhje me garat nacionale të arsimit.
- Kemi realizuar takimim me Ojq-ën Artizanale “ Tradita Popullore” me Znj Edlira Sulaj për bashkëpunime në vitin në vazhdimësi në lidhje me trashëgimin tonë të pasur kulturore më saktësisht me veshjet tradicionale shqiptare.
- Kemi realizuar takime me Kryetarin e Federatës së Sportit Shkollor të Kosovës z. Adrian Telaku dhe me shefin e departamentit të sportit të Kosovës z. Fikret Shatri.
- Një bashkëpunim të ndërsjelltë kishim edhe me **Agjencioni Pyjor i Kosovës**, lidhur me planifikimin për restaurimin e asetit nga trashëgimia jonë arkitektonike **”Mulliri i Hysenajve”** në Graboc.

- Në kuadër të detyrave që ka DKRS-ja, kemi shpallur dy thirrje publike, ku ju është mundësuar shumë OJQ-ve kulturore, sportive dhe rinore për të aplikuar si bartëse për realizimin e projekteve vjetore. Për këtë janë emëruar komisione të veçanta për vlerësimin e projekteve, gjithnjë duke u bazuar në rregulloret dhe ligjet në fuqi- për ndarjen e subvencioneve.
- Për herë të parë DKRS-ja, ka filluar projektin në investimin e fushës së trashëgimisë kulturore në vlerë prej 50 mijë euro. Në sate të këtij investimi është përzgjedhur aseti kulturor i kësaj fushe”**Mulliri i Behramjave**”-Graboc
- Këtë vitë është realizuar fusha sportive në fshatin Raskovë
- Poashtu është realizuar projekti për renovimin e palestrës sportive “Adem Jashari”
- Është rrealizuar projekti për shtatorën “Xhavit Haziri” sëbashku me bazament.
- Vlen të theksohet se këto ditë ka filluar inventarizimi i objektit të Shtëpisë së Kulturës”Xhavit Haziri”.
- Është realizuar projekti për festat e fundvitit “ Dekorimi i qytetit”
- Të ardhurat nga palestra sportive “ Adem Jashari” për vitin 2019 ishin: 1925 euro



## SHTËPIA E KULTURËS “XHAVIT HAZIRI”

1. Ky objekt kulturor është institucion varës DKRS-së dhe si i tillë shërben kryesisht për zhvillimin e aktiviteteve kulturore në Komunën e Obiliqit. Hapësira e mbrendshme posedon: sallën me 480 ulëse, sallën e leximit, sallën e takimeve, dy zyre administrative, dhomën e ondulimit dhe dy zheshtore për trupën artistike. Shtëpia e Kulturës “Xhavit Haziri”-u përruar me 14 Qershor 2019 e cila tashmë është funksionale dhe aktualisht po zhvillohen veprimtari kulturore në fusha të ndryshme të kulturës. Që nga koha e përrimit janë mbajtur këto aktivitete:

- Manifestimi Kulturor”Qershori, Muaji i Krenarisë Sonë”
- Aktiviteti kulturor” Unë jam talent”
- Shfaqja teatrale nga Teatri i Qytetit
- Manifestimi kulturor “ Ditët e Diasporës”
- Përrimi i shtatorës “Xhavit Haziri”
- Debat publik për çështjet ambientale nga GAIA-Kosovë(Zyra e Bashkimit Evropian)
- Aktivitete Rinore nga Qendra Rinore
- Ekspozitë fotografish temë e së cilës ishte edukimi shëndëtsor për fëmijë të realizuar nga OJQ “S’Bunker”
- Koncert përmbledhës festiv nga Ansambli i Qytetit të Obiliqit
- Organizimi nga DKRS- ja , “Spotisti i vitit”

### Mallra dhe Shërbime

1. Kontrata për furnizim me lule.
2. Kontrata për furnizim me material për kulturë.
3. Kontrata për furnizim me ushqim dhe pije.
4. Material higjenik për palestrën sportive “Adem Jashari”.

## 5. Material higjenik për shtëpin e kulturës “Xhavit Haziri”.

**RAPORTI VJETOR I PUNËS – ZYRA PËR KOMUNITETE DHE KTHIM**

Zyra për Komunitete dhe Kthim e Komunës së Obiliqit është pjesë e administratës së përgjithshme komunale dhe ka dy shërbime si: 1) Zyrën e kthimit e cila punëson një koordinatör dhe tre zyrtarë dhe 2) Shërbimin e riintegritit që punëson një koordinatör dhe tre zyrtarë. Së bashku me shefin ZLKK-në e përbëjnë 9 zyrtarë civilë komunalë.

**SHËRBIMI PËR KTHIM**

Sa i përket raportit vjetor të Zyrës komunale për komunitete dhe kthime (OKZP) të Komunës së Obiliqit gjatë vitit 2019, kjo zyrë ka vazhduar me punën e projektit RRR-5. Nga 11 komunat, ka përfshirë edhe komunën tonë. Në fazën e parë nga 31 përfitues, janë miratuar 26 përfitues, të tjerët mbetën në pritje për fazën tjetër, por në grupin qendror të punës, është kërkuar që 5 përfitues të kalojnë për vitin e ardhshëm për shkak të vetë procesit kohor. Për shkak të mungesës së kohës, përfaqësuesit e IOM deklaruan se ata nuk mund të fillojnë të gjitha punët menjëherë për këtë arsye, 12 shtëpitë e tjera do të fillojnë vitin e ardhshëm. Për 14 familje që përfunduan punimet u është dhënë ndihma tjetër e ofruar si më poshtë: pako e mobiljeve, pajisjet shtëpiake, ushqimi, furnizimet higjienike, dru për ngrohje, ndërsa projekti për të gjeneruar të ardhura për kthim të qëndrueshëm nuk është miratuar. Shtëpitë janë ndërtuar sipas kriterëve dhe standardeve e parashikuara të projektit për përdoruesit në bazë të numrit të anëtarëve të familjes. UNHCR, së bashku me ZLKK, ka regjistruar familjet që janë kthyer dhe vendosur në shtëpi të ndërtuara rishtas.

Shtëpitë e përfunduara	Serbe	Shqiptare	Rome	Ashkali	Egjiptian e	Boshnja ke	Gjithsej
2019	6	1	5	1	///	///	14
Numri i familjeve të kthyera 2019	6	1	5	1	///	///	14

Shtëpitë që transferohen për vitin tjetër	Serbe	Shqiptare	Rome	Ashkali	Egjiptian e	Boshnja ke	Gjithsej
2020	6	///	5	1	///	///	12

Grupi punues komunal propozoi 31 familje për Komisionin qendror, ku ata takoheshin rregullisht dhe përpunuan përfituesit e tyre çdo muaj, të cilat u dorëzuan përmes komunës sipas normave ligjore të dhëna në Rregulloren Nr. 01/2018 për kthimin e personave të zhvendosur dhe zgjidhje të përhershme.

Pesë familjet e miratuara nga grupi komunal i punës dhe grupit qendror do të rishqyrtohen në nivelin qendror përgjatë vitit 2020.

Zyra për komunitete ka bërë kërkesë për një leje të kushtëzuar për ndërtimin e shtëpive për familjet e miratuara nga Komisioni qendror dhe na janë refuzuar katër kërkesa, por do të përpiqemi që edhe për to të bëjmë një zgjidhje. Po ashtu për kërkesat e të njejtëve kem aplikuar për rrjet elektrik dhe u miratuan të gjitha dhe menjëherë aplikua një leje ndërtimi, për çka morëm përgjegje pozitive vetëm se nau desh shumë kohë dhe kjo është arsyeja pse ndërtimi i objekteve u vonua.

